



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore të Pjetër Shalës, seanca e apelit është caktuar të mbahet të enjten dhe të premten e ardhshme, më 15 dhe 16 maj 2025. Të enjten, seanca do të mbahet nga ora 13:30 deri në orën 17:10 pasdite. Të premten, seanca do të mbahet paradite, duke filluar nga ora 10:00.

Gjatë seancës së apelit, kryegjykatësja pritet të bëjë komentet hyrëse, pasuar nga parashtrimet gojore nga Mbrojtja, Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe Mbrojtja e Viktimave. Në një urdhër të lëshuar më 5 maj, Paneli i Apelit renditi një numër pikash që palët mund t'i trajtojnë gjatë parashtrimeve të tyre në seancë.

Pjetër Shala u shpall fajtor nga Trupi Gjykses për krimet e luftës të ndalimit arbitrar dhe vrasjes së paligjshme më 16 korrik 2024 dhe u dënua me 18 vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim. Më 29 nëntor 2024, Trupi Gjykses lëshoi urdhrin për zhdëmtime në lidhje me tetë viktima pjesëmarrëse në proces, me të cilin urdhëroi z. Shala të paguante një shumë prej 208.000 eurosh si kompensim për dëmin fizik, mendor dhe material shkaktuar viktimave të krimeve për të cilat u shpall fajtor.

Z. Shala apeloj shpalljen e fajësisë, dënimin e tij dhe urdhrin për zhdëmtim. Seanca e ardhshme pritet të jetë në lidhje me apelin e tij kundër aktgjykimit dhe dënimit.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, më 2 maj, Trupi Gjykses hodhi poshtë një kërkesë të Mbrojtjes së Veselit për të apeluar dy vendime të mëparshme të gjykatësve në lidhje me pranueshmërinë e provave. Trupi Gjykses konstatoi se vlera provuese e provave të paraqitura nuk zhbëhej prej efektit dëmtues ndaj të akuzuarit.





Më 2 maj, Mbrojtja e Viktimave parashtrori dy aktekspertiza dhe kërkoi që ato të pranohen si prova. Një aktekspertizë trajton dëmin psikologjik të pësuar nga viktimat pjesëmarrëse në këtë proces, ndërsa tjetra vlerëson dëmin material të pësuar nga viktimat. Mbrojtja e Viktimave kërkoi gjithashtu që aktekspertizat përkatëse nga gjykimet e Salih Mustafës dhe Pjetër Shalës të pranohen si prova, duke pasur parasysh se ato edhe kanë të bëjnë me viktimat pjesëmarrëse në çështjen gjyqësore për krime lufte *Thaçi dhe të tjerët*.

Në një seancë për ecurinë e çështjes të mbajtur rishtas, gjykatësit urdhëruan Mbrojtjen e Viktimave që jetë gati për të paraqitur argumentet e veta në korrik të këtij viti.

Në çështjen gjyqësore të Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut, Isni Kilajt dhe Hajredin Kuçit për ndikim të pretenduar ndaj dëshmitarëve, Gjykatësja e Procedurës Paraprake hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes së Smakajt për të apeluar vendimin e saj të mëparshëm në lidhje me kërkesën e Smakajt për pezullim të procesit, për shkak se kërkesa u dorëzua pas afatit përkatës.

Në vendimin e saj të fundit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake shpjegoi gjithashtu se, edhe nëse kërkesa do të ishte dorëzuar në kohë, leja për apel nuk do të ishte miratuar sepse pika e parë dhe pika e dytë që ngriti Mbrojtja në kërkesë thjesht shprehin mospajtim me vendimin e mëparshëm të gjykatës, ndërsa pika e tretë e ngritur nga Mbrojtja përbënte shtrembërim të qartë të vendimit të gjykatës.

Në lajme të tjera, të premtën, më 2 maj, gjykatësi Keneth Roberts informoi Kryetaren e Dhomave të Specializuara Ekaterina Trendafilova se do të tërhiqet nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë për shkak të mungesës së kohës dhe prioriteteve të tjera. Kryetare Trendafilova shprehu mirënjohje për kontributin e gjykatësit Roberts në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara.

